

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takim *online* me misionin e Bankës Botërore

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar–gusht 2021

Zhvillime të tjera

- AMF nxjerr për konsultim publik setin e parë të projektregulloreve në zbatim të Ligjit nr. 66/2020
- Publikohet “Gjeografia e Sigurimeve 2020”
- Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Mbi sigurimet gjithëpërfshirëse në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore”

Publikime Profesionale

- Global Risk Regulator “Fitch Ratings” paralajmëron bankat mbi ngjarjet kibernetike sistemike
- IOSCO Publikohet udhëzimi për ndërmjetësit dhe menaxherët e aseteve që përdorin Inteligjencën Artificiale dhe Mësimin e Makinerisë (*Artificial Intelligence, AI dhe Machine Learning, ML*)

Informacione Ndërkombëtare

- Greqi
- Kosovë
- Kroaci
- Mali i Zi
- Maqedoni
- Poloni
- Rumani

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takim *online* me misionin e Bankës Botërore



15 shtator 2021 - Takim *online* me misionin e Bankës Botërore në Tiranë

Përfaqësuesit e misionit të Bankës Botërore për sektorin financiar vlerësuan rolin e Autoritetit në garantimin e stabilitetit financiar përgjatë pandemisë dhe shprehën angazhimin e tyre për të vijuar bashkëpunimin.

Ecuria e tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe zbatimi i projektit të asistencës me mbështetjen e Bankës Botërore ishin në fokus të takimit virtual mes Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe ekipit të misionit të Bankës Botërore për sektorin financiar.

Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së paraqiti ecurinë e tregjeve financiare jobankare përgjatë pjesës së parë të vitit 2021, si edhe ndikimet e pandemisë gjatë vitit 2020. Z. Mete theksoi se situata në tregjet nën mbikëqyrje i është kthyer normalitetit, me disa tregues që kanë shfaqur rritje edhe krahasuar me vitin 2019, përpara pandemisë. Megjithatë, AMF po monitoron me kujdes, në vijimësi, zhvillimet në këto tregje.

Z. Mete informoi ekipin e misionit të Bankës Botërore mbi ecurinë e procesit të hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të reja për tregjet nën mbikëqyrje, ku Autoriteti për një pjesë të rregulloreve po asistohet nga ekspertët ndërkombëtare.

Përfaqësuesit e misionit të Bankës Botërore për sektorin financiar vlerësuan rolin e Autoritetit në garantimin e stabilitetit financiar përgjatë pandemisë dhe shprehën angazhimin e tyre për të vijuar bashkëpunimin.

Pjesëmarrësit diskutuan gjithashtu në lidhje me ecurinë e projektit të financuar nga Sekretariati Shtetëror Zvicëran për Çështje Ekonomike (SECO), me mbështetjen e Bankës Botërore, për tregjet e kapitalit dhe të sigurimeve.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-gusht 2021


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-gusht 2021 kapën vlerën 12,674 milionë lekë, ose 19.28% më shumë se në periudhën janar-gusht 2020. Gjatë periudhës janar-gusht 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 745,033 me një rritje prej 22.22% krahasuar me periudhën janar-gusht 2020.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.68% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.13%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 40.08% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 59.92% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-gusht 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,622 milionë lekë, ose 7.2% më pak se në periudhën janar-gusht 2020, ndikuar kryesisht nga pagesa e pjesës më të madhe të dëmshpërblimeve për tërmetet e fundvitit 2019 gjatë vitit të kaluar.

Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-gusht 2021 kapën vlerën 2,647 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 39.68% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-gusht 2021 (Në %)



Gjatë periudhës janar-gusht 2021, dëmet e paguara bruto të sigurimit motorik kapën vlerën 2,647 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 39.68% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Projektregullore

Faqe Kryesore » Legjislacioni » Projektakte » Projektregullore

Projektregullore "Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digital"

Projektregullore "Për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe fondet e veta të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë"

Projektregullore "Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm"

VERIFIKONI POLICËN TUAJ »

DEPOZITO ANKESËN ONLINE

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
Rruga "Dora D'istria", Nr.10, P.O. Box 8363, Tiranë,
Shqipëri

Projektregulloret
gjenden në:

<http://amf.gov.al/projekte.asp?id=2>

AMF nxjerr për konsultim publik setin e parë të projektregulloreve në zbatim të Ligjit nr. 66/2020

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka hartuar setin e parë të projektregulloreve në zbatim të Ligjit nr. 66/2020 "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë".

Aktet janë hartuar mbështetur në projektregulloren nr. 648/2012 të Parlamentit dhe Këshillit European "On Markets in Crypto-assets, and amending Directive (EU) 2019/1937".


Dokumentet që publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, janë:

- [Projektregullore "Për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe fondet e veta të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë";](#)
- [Projektregullore "Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital";](#)
- [Projekt për disa ndryshime të Rregullores nr.17, datë 21.03.2007, "Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuar dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare".](#)

Gjeografia e Sigurimeve

2020

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare publikon Gjeografinë e Sigurimeve 2020

Gjeografia e Sigurimeve 2020 pasqyron në mënyrë të detajuar shpërndarjen e primeve të shkruara bruto, dëmeve të paguara si edhe primit për frymë, sipas prefekturave.

Duke analizuar shpërndarjen gjeografike të primit të shkruar bruto, vërehet një përqendrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha, si Tirana me 59.24% të totalit të primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2020, Durrësi me 7.41%, Fieri 5.52%, Shkodra 4.62%, Vlora 4.61%, Korça 4.52%. Kjo tendencë përqendrimi ka vijuar e tillë për një periudhë 13-vjeçare.

Një tregues tjetër i rëndësishëm i tregut të sigurimeve është dendësia e sigurimeve. Për vitin 2020 ky tregues është rreth 5,866 lekë për frymë, me një ulje rreth 302 lekë krahasuar me një vit më parë.


Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, prefektura Tiranë me 10,780 lekë për frymë zë vendin e parë, e pasuar nga prefektura Gjirokastrë me 5,465 lekë për frymë dhe më tej Durrësi me 4,214 lekë për frymë, Vlora me 4,074 lekë për frymë dhe Shkodra me 3,887 lekë për frymë.

Ky publikim përfshin gjithashtu edhe informacion të hollësishëm për dëmet e paguara gjatë vitit 2020 sipas prefekturave, duke krijuar edhe mundësinë e krahasimit të këtyre treguesve me ato të një viti më parë. Përsëri pjesën më të madhe të dëmeve të paguara e ka prefektura e Tiranës me 72.42%, e pasuar nga prefektura Durrës me 12.52%.

Gjeografia e sigurimeve 2020 gjendet në:

<http://amf.gov.al/statistika.asp?id=4>

Zhillohet konferenca ndërkombëtare “Mbi Sigurimet Gjithëpërfshirëse në Rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore”



Në datat 1-2 shtator 2021 u zhvillua konferenca ndërkombëtare “Sigurimet gjithëpërfshirëse në rajonin CEET” (Evropën Qendrore dhe Lindore si edhe Transkaukazinë).

Konferenca e këtij viti u organizua nga Fondacioni Munich Re, Iniciativa për Qasje në Sigurime (a2ii), Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), Rrjeti i Mikrosigurimeve dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (AZN). Në konferencë morën pjesë 188 pjesëmarrës nga 44 vende të rajonit.

Konferenca u zhvillua në katër sesione:

- Vështrim i përgjithshëm mbi sigurimet gjithëpërfshirëse në rajonin CEET;
- Rreziku klimatik dhe sigurimi bujqësor;
- Digjitalizimi;
- Krijimi i vlerave për të siguruarit.

Në sesionin e parë, prezantoi edhe Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtor Ekzekutiv i AMF-së punimin me titull “Sfidat dhe mundësitë e sigurimit gjithëpërfshirës në rajon”. Në prezantim, Znj. Kaçi paraqiti situatën aktuale në tregun e sigurimeve në Shqipëri, eksperiencat në iniciativën për sigurimin gjithëpërfshirës në Shqipëri, si edhe mundësitë e zhvillimit në rajon. Disa nga konceptet kryesore të prezantimit ishin:

- Sigurimi duhet të jetë i arritshëm për të gjitha klasat shoqërore, pavarësisht nga pasuria dhe statusi i të ardhurave të tyre. Kështu grupet vulnerabël të shoqërisë mund të kenë akses dhe të përfitojnë nga këto skema sigurimi. Kjo mund të bëhet përmes sigurimit gjithëpërfshirës si pjesë e gjithëpërfshirjes financiare;
- Duke marrë parasysh situatën ekonomike dhe të tregut, sigurimi gjithëpërfshirës është një mjet financiar për të mbrojtur njerëzit me të ardhura të ulëta nga rreziqet specifike, veçanërisht në ato vende të rajonit me të ardhura të ulëta dhe norma të ulëta të depërtimit të sigurimit.

Sipas anketimeve të A2ii industria e sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore dominohet nga sektori i Jo-Jetës. Linku gjendet në:

[a2ii report on the Inclusive Insurance Regulatory Landscape in the CEET Region](#).

Në sesionet e tjera të konferencës diskutuan z. Gorazd Čibej, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Slloveni dhe njëkohësisht edhe koordinatori rajonal i IAIS për rajonin CEET, z. Klime Poposki, Proff. Assoc. Universiteti i St. Kliment Ohër, Maqedonia e Veriut, z. Sergej Simoniti, kryetar i Bordit Drejtues, Coface PKZ Zavarovalnica d.d. Slloveni, z. Alexandru Ciuncan, Drejtor i Përgjithshëm, Shoqata Kombëtare e kompanive të Sigurimeve dhe Risigurimeve, Rumani, znj. Rossitza Wartonick, Drejtore Ekzekutive, Shoqata e siguruesve të Bullgarisë, si edhe ekspertë nga kompani ndërkombëtare të sigurimeve.

Sipas studimeve dhe anketimeve të A2ii* industria e sigurimeve në vendet e CEET** dominohet nga sektori i Jo-Jetës. Sigurimi i Jetës luan një rol më pak të rëndësishëm dhe është ende mjaft i pazhvilluar, me përjashtim të disa juridiksioneve të BE-së. Sigurimi motorik mbetet segmenti kryesor i biznesit në CEET, duke zënë 53.4% të primeve të sigurimit të Jo-Jetës. Asnjë nga 31 vendet në rajonin e CEET nuk ka një rregullore specifike të sigurimit gjithëpërfshirës, ose një përkufizim të përcaktuar për mikrosigurimet /sigurimet gjithëpërfshirëse.

* Bazuar në [a2ii report on the Inclusive Insurance Regulatory Landscape in the CEET Region](#)).

** Sipas klasifikimit të IAIS vendet që përfshihen në CEET janë: Armeni, Azerbajxhani, Bjellorusia, Bosnja- Hercegovina, Bullgaria, Estonia, Gjeorgjia, Hungaria, Izraeli, Kazakistani, Kosova, Kirgistani, Kroacia, Letonia, Lituania, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Polonia, Republika Çeke, Rumania, Rusia, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Shqipëri, Taxhikistan, Turqia, Turkmenia, Ukraine, Uzbekistan



Subjects / Reporting and Governance

Fitch Ratings warns banks over systemic cyber events

“Fitch Ratings” paralajmëron bankat mbi ngjarjet kibernetike sistemike

Justin Pugsley

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Reporting-and-Governance>

Sulmet kibernetike janë një rrezik material për bankat amerikane pasi një incident mund të ketë shumë pasoja përtej masave të menjëhershme të rikuperimit. Madje pasojat mund të përhapen edhe në bankat e tjera me pasoja potencialisht shkatërruese.

IOSCO publikon udhëzimin për ndërmjetësit dhe menaxherët e aseteve duke përdorur Inteligjencën Artificiale (IA) dhe Mësimin e Makinerisë (ML)

<https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS616.pdf>

Bordi i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve (IOSCO) publikoi udhëzimin për të ndihmuar anëtarët e tij të rregullojnë dhe mbikëqyrin përdorimin e Inteligjencës Artificiale (IA) dhe Mësimin të Makinerisë (ML) nga ndërmjetësit e tregut dhe menaxherët e aseteve. Më parë një raport i tillë ishte publikuar për konsultim në faqen online të organizatës.

Me përdorimin e IA dhe ML mund të përfitojë ndërmjetësit e tregut, menaxherët e aseteve dhe investorët duke rritur efikasitetin e proceseve ekzistuese, duke ulur koston e shërbimeve të investimeve dhe duke liruar burimet njerëzore për aktivitete të tjera. Megjithatë, ky përdorim mundet edhe të krijojë ose përforcojë rreziqe, duke minuar potencialisht efikasitetin e tregut financiar dhe duke dëmtuar konsumatorët dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

Për më tepër, përdorimi i AI dhe ML nga ndërmjetësit e tregut dhe menaxherët e aseteve po rritet, pasi po evoluon edhe kuptimi i tyre për teknologjinë. Raporti i IOSCO-s përshkruan sesi ndërmjetësit e tregut dhe menaxherët e aseteve përdorin aktualisht IA dhe ML për të zvogëluar koston dhe për të rritur efikasitetin. Udhëzuesi vëren se rritja e përdorimit të platformave të tregtimit elektronik dhe disponueshmëria në rritje e të dhënave kanë bërë që firmat të përdorin në mënyrë progresive IA dhe ML në aktivitetet e tyre tregtare dhe këshilluese, si edhe për funksionet e menaxhimit të rrezikut dhe pajtueshmërisë.



GREQI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Shoqata e Kompanive të Sigurimeve në Greqi (HAIC), primet e shkruara bruto për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 nga anëtarët e kësaj shoqate arritën në 2.13 miliardë EUR, ose rreth 9.4% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2021, segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit mbi 3.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 1.1 miliardë EUR. Në sigurimet e Jo-Jetës, vëllimin më të madh të primeve e zë sigurimi motorik, MTPL me 358 milionë EUR; sigurimi i pronës me 216 milionë EUR; dhe sigurimi Kasko me 116 milionë EUR.

Në sigurimet e Jetës rritja ishte me rreth 16.5% duke arritur në 1.03 miliardë EUR. Rritja më e madhe në këtë kategori erdhi nga policat e sigurimit të Jetës të kombinuara me skema investimesh (*Universal Life Insurance*), të cilat u rritën me 56% duke arritur në 284 milionë EUR, kundrejt 182 milionë EUR që ishin në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.

KOSOVA

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, 13 shoqëri aktive të siguruesve të Kosovës raportuan një fitim neto të përgjithshëm prej 1.5 milionë EUR për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021. Kjo shifër shpreh një rënie të ndjeshme krahasuar me fitimin neto të tregut të sigurimeve për gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar, me 4.9 milionë euro. Në të njëjtën kohë, vlera e aseteve totale të mbajtura nga shoqëritë e sigurimeve të Kosovës u rrit, duke arritur në 230 milionë EUR, nga 208.6 milionë EUR që ishte një vit më parë.

Po sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Kosovës, në gjashtëmujorin e parë 2021, volumi i primeve të shkruara bruto arriti në 55.2 milionë EUR, kundrejt 46.4 milionë EUR. Sigurimi i Jetës realizoi 2.2 milionë EUR prime të shkruara bruto, ndërsa segmenti i sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 18.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 53.1 milionë EUR.

KROACI

www.xprimm.com

Byroja Kroate e Sigurimeve raportoi se për periudhën janar–shtator 2021, vëllimi i primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Kroaci u rrit me 12.09%, në terma vjetore, duke arritur në 8.13 miliardë HRK ose rreth 1.09 miliardë EUR.

Sipas Byrosë Kroate të Sigurimeve, segmenti i sigurimit të Jo-Jetës në periudhën janar-shtator 2021, u zgjerua me 12.68% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 6.15 miliardë HRK, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës u rrit me 10.32%, duke arritur në 1.98 miliardë HRK.

Në fund të gushtit 2021 kishte 15 shoqëri sigurimi të regjistruara në Kroaci.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të fundit të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi, ISA, në fund të qershorit 2021, tregu malazez i sigurimeve arriti një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 49 milionë EUR, ose rreth 2.5 milionë EUR më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Primet e shkruara bruto në Sigurimet e Jo-Jetës, arritën në rreth 39.8 milionë EUR, duke zënë 81.25% të tregut të sigurimeve të Malit të Zi. Primet e shkruara bruto në Sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 6.5%, në bazë vjetore. Ndërsa, primet e shkruara bruto në sigurimet e Jetës u rritën me 1%, gjatë gjashtëmujorit të parë 2021, duke arritur në 9.2 milionë EUR.

MAQEDONIA E VERIUT

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve të Maqedonisë së Veriut e mbylli gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 me një vëllim të primeve të shkruara bruto në vlerë prej 95.7 milionë EUR, duke shënuar një rritje prej 14.6% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Edhe dëmet e paguara u rritën me 22%, duke arritur në rreth 36 milionë EUR. Rritja e tregut ishte pothuajse e njëjtë për të gjitha linjat kryesore të biznesit.

Rritja në produktet e sigurimeve shëndetësore ishte e ndjeshme, sidomos e parë kjo në kushtet e veçanta të pandemisë COVID-19. Gjatë gjysmës së parë të viti 2021, numri i kontratave për policat e sigurimit shëndetësor privat u rrit me 48%. Vlera e dëmeve të paguara për sigurimet shëndetësore private arriti në 5% të shumës totale të dëmeve të paguara bruto në gjashtëmujorin e parë të 2021.

Në klasat e sigurimeve të Jo-Jetës, normat më të larta të rritjes u regjistruan në sigurimin e pronës, me një rritje 26.8% në terma vjetore, si edhe sigurimi MTPL me rritje 17.75% në terma vjetore. Gjithashtu edhe dëmet e paguara në këto dy klasa u rritën me ritme të krahasueshme ose edhe më të larta.

POLONI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Dhoma Polake e Sigurimeve, PIU, gjatë gjysmës së parë të vitit 2021 tregu polak i sigurimeve tregoi shenja të rimëkëmbjes, me një dinamikë pozitive rritjeje të primeve të shkruara bruto me 8% në vit, duke arritur në 7.6 miliardë EUR.

Gjatë kësaj periudhe, siguruesit polakë paguan 4.4 miliardë EUR dëme për të siguruarit e dëmtuar. Pagesat për sigurimin e Jetës u rritën dhe kjo kryesisht si rezultat i rritjes së vdekshmërisë të shkaktuar nga pandemia Covid-19. Rritja e pagesave të dëmeve për Sigurimin Kasko ishte linja e dytë e biznesit me rritjen më të madhe ndër këto linja.

Në segmentin e tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, sigurimet motorike dhe klasat e sigurimit të pronës kanë shënuar rritjen më të madhe të primeve të shkruara bruto. Përsa i përket dëmeve, sigurimi motorik dhe veçanërisht sigurimi Kasko kanë patur rritjen më të madhe të pagesave të kryera.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, nuk pati humbje të mëdha përsa i përket dëmeve të shkaktuara nga moti. Kompensimet që lidhen me fatkeqësitë natyrore dhe dëme të tjera materiale në pronë arritën në 285.46 milionë EUR, rreth 11% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

RUMANI

www.xprimm.com

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë ka vendosur të refuzojë planin afatshkurtër të financimit dhe planin e rimëkëmbjes, të tërheqë licencën e funksionimit, të deklarojë falimentimin dhe të paraqesë kërkesën për hapjen e procedurave të falimentimit për shoqërinë e sigurimit *"CITY Insurance"* në Rumani. Kjo shoqëri është ndër më të mëdhatë në vend me një aktivitet që zë rreth 20% të industrisë totale të sigurimeve dhe 45% të tregut për produktet e sigurimit motorik, MTPL.

Bashkimi Kombëtar i Kompanive të Sigurimit dhe Risigurimit në Rumani, UNSAR, njoftoi se ka marrë parasysh vendimin e Këshillit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Përfaqësuesit e UNSAR deklaruan se "... ndikimi është sigurisht i rëndësishëm, por tregu i sigurimeve MTPL në Rumani do të vazhdojë të funksionojë dhe do ta kapërcejë këtë situatë. Mbajtësit e policave të sigurimit MTPL të lëshuara nga kjo kompani (*"CITY Insurance"*) dhe palët e dëmtuara do të mbrohen me ligj përmes mekanizmit mbrojtës të ndërtuar në këtë drejtim".

Byroja Rumune e Siguruesve të Makinave (BAAR) njoftoi se është informuar për tërheqjen e licencës së operimit të *"CITY Insurance"* nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. BAAR konsideron se, duke qenë se siguruesi nuk i plotësonte më treguesit e aftësisë paguese, d.m.th. kapitalin minimal, tërheqja e licencës së funksionimit nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve është në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e përgjithshme të qeverisjes në sektorin e sigurimeve. Përfaqësuesit e BAAR theksuan se "... Ne jemi të bindur se të gjithë mbajtësit e policave të sigurimit të marra nga *"CITY Insurance"* do të përfitojnë, kur është e përshtatshme, nga kompensimi përmes Fondit të Garancisë së Sigurimeve." BAAR thekson se do të veprojë vetëm në përputhje me ligjin, standardet më të larta të profesionalizmit dhe efikasitetit, pa barriera burokratike për të përmbushur rolin e tij.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al